



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORTI I KONSOLIDUAR “PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT
TË REKOMANDIMEVE, TË VITIT 2023”

RAPORTI I KONSOLIDUAR I AUDITIMIT PËR ZBATIMIN E
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E EVADUARA NË VITIN 2023

Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

Shkurt 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqja
1	Përmbledhje ekzekutive	3-4
1.1	Hyrje	3-4
1.2	Objektivat	4
1.3	Qëllimi	4
1.4	Metodologjia	4
1.5	Konkluzione	4
1.6	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	4
1.7	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara për periudhën 2023	4
1.8	Këshillin e Lartë Gjyqësor	4-10
1.9	Instituti i Gjeoshkencave	10-18
1.10	Anekse	18-20

1. Përmbledhje ekzekutive

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, të evaduar gjatë vitit 2023, në zbatim të Programit të Auditimit me Nr. 1420/2 prot., datë 27.11.2024 në institucionet:

- Këshillin e Lartë Gjyqësor
 - Instituti i Gjeoshkencave
- ka rezultuar si në vijim:

Sa i përket zbatimit të afateve për kthim përgjigje pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit konstatohet se,

Mbi respektimin e afateve të raportimit:

Afati 20 ditor

-Këshillin e Lartë Gjyqësor ka respektuar afatin prej 20 ditë për kthimin e përgjigjesme shkresën Nr.4388/14 datë 16.02.2024 për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Instituti i Gjeoshkencave nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 20 ditor k në kundërshtim të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” të nenit 30, pika 2.

Afati 6 mujor

-Këshillin e Lartë Gjyqësor kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor me shkresën Nr. 4388/26 prot., datë 10.07.2024, në zbatim të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” të nenit 30, pika 2.

-Instituti i Gjeoshkencave nuk kanë kthyer përgjigje në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor në kundërshtim të Ligjit Nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” të nenit 30, pika 2b. Lidhur me detyrimin e institucioneve për të raportuar në KLSH mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor konstatohet se:

Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve u konstatua se, rekomandimet janë pranuar në masë të plotë nga të dyja subjektet, konkretisht nga 21 masa të rekomanduara gjithsej, janë pranuar 21 masa ose 100%.

Zbatuar plotësisht 16 masa ose 76.2 %, zbatuar pjesërisht 3 masa ose 14.2 %, në proces zbatimi 1 masë ose 4.8% si dhe 1 masë e pa zbatuar ose 4.8 %.

1.1 Hyrje

K Kontrolli i Lartë i Shtetit auditori Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme në subjektet e lartpërmendur mbështetur në programet respektive të auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me objekt: “Për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023”, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe të Manualit për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Regjistrisë elektronik institucionale.

Auditimi u krye nga:

1. M.N, (përgjegjës grupi)
2. J.K anëtar

Auditimi ka filluar më, 02.12.2024.
Auditimi ka përfunduar më, 20.12.2024.

1.2 Objektivat

1. Hartimi i programit (Planit të veprimit). Respektimi i afateve ligjore për njoftimin e KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afateve të përcaktuara në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
2. Zbatimi i rekomandimeve për përmirësime në legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi i rekomandimeve për masat me karakter organizativ.
4. Zbatimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit ekonomik.
5. Zbatimi i rekomandimeve për përdorim me efektivitet dhe ekonomicitet.
6. Zbatimi i rekomandimeve për masa disiplinore dhe administrative.
7. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

1.3 Qëllimi

Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna, nga auditimet e mëparshme, koherencës së tyre dhe përgjegjshmërisë menaxheriale referuar standardeve të auditimit.

1.4 Metodologjia

Duke pasur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit dhe dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, u auditua niveli i zbatimit të secilit rekomandim në subjektet e përzgjedhura, vlerësuar sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë fazës së kryerjes së auditimit në terren.

1.5 Konkluzione

Për çështjet e shqyrtuara janë zhvilluar ballafaqime gjatë fazës së auditimit në terren dhe në përfundim të tij janë mbajtur akt verifikime për çdo subjekt të audituar, mbi rezultat e të cilit është përgatitur ky Raport Auditimi.

1.6. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton se:

Zbatuar plotësisht 16 masa ose 76.2 %, zbatuar pjesërisht 3 masa ose 14.2 %, në proces zbatimi 1 masë ose 4.8% si dhe 1 masë e pa zbatuar ose 4.8 %.

1.7. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023.

Të analizuara dhe të detajuara sipas çdo subjekti dhe sipas llojit të masave të rekomanduara, niveli i zbatimit të tyre paraqitet si vijon:

1.KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

1.1 PËRMBLEDHJE

K Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditim tematik në **Këshillin e Lartë Gjyqësor** “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduara në vitin 2023”, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 deri më datën 30.09.2023, përcjellë me shkresën Nr. 689/9 Prot, datë 31.01.2024, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja "j", të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Këshillin e Lartë Gjyqësor ka respektuar këtë afat duke kthyer përgjigje sipas shkresës së administruar në institucion me Nr.4388/14 Prot, datë 16.02.2024.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecures së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", subjekti i audituar ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit prej 6 muaj, me shkresën Nr. 4388/26 Prot, datë 10.07.2024.

III. Rekomandimet e KLSH-së

Sipas shkresës Nr. 689/9 Prot, datë 31.01.2024, për Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi Auditimin e Përputhshmërisë" të ushtruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, sipas programit të auditimit Nr.689/2 Prot, datë 08.09.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2021 deri në 30.09.2023, janë rekomanduar 12- Masa organizative, nga ku janë dhënë 14 –rekomandime të pranuar plotësisht të cilat kanë statusin e ecures së zbatimit si vijon 14 zbatuar plotësisht dhe 1-Masë Disiplinore për të cilin është dhënë 1-rekomandim i pranuar plotësisht i cila ka statusin e ecures së zbatimit, i zbatuar plotësisht.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH-së

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-s me Nr.689/9 Prot., datë 31.01.2024 statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa Organizative	14	14	-
2	Masë disiplinore	1	1	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit.

Në mënyrë të përmblledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	14 Rekomandime	14	-	-	-
2	Masë disiplinore	1 Rekomandim	1	-	-	-
	Total	15	15	-	-	-

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr.1420/2 prot., datë 27.11.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye nga:

1. M.N, përgjegjëse grupi
2. J.K, anëtar.

Auditimi ka filluar më 02.12.2024.

Auditimi ka përfunduar më 20.12.2024.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 689/9 Prot., datë 31.01.2024, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUZIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti Këshillin e Lartë Gjyqësor, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.689/9 Prot., datë 31.01.2024, rezulton se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë

-Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 12- Masa organizative, nga ku janë dhënë 14 –rekomandime të pranuar plotësisht të cilat kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon 14

zbatuar plotësisht dhe **1-Masë Disiplinore** për të cilin është dhënë **1-rekomandim** i pranuar plotësisht i cila ka statusin e ecurisë së zbatimit, i zbatuar plotësisht.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezultoi në nivel 100%, konkretisht nga **15** rekomandime gjithsej, janë pranuar **15** rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **100%**, nivel ky i cili tregon vlerësimin e këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:

Nga auditimi i ushtruar në Këshillin e Lartë Gjyqësor për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.01.2021 deri në 30.09.2023 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH Nr.14, datë 29.01.2024, përcjellë. me shkresën Nr.689/9 Prot., datë 31.01.2024, rezultoi si më poshtë vijon:

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Këshillin e Lartë Gjyqësor**, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën me Nr. 4388/14 Prot, datë 16.02.2024, brenda afatit ligjor.

-Sa më sipër rezultoi, se është zbatuar afati **20 ditor** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti ka raportuar në KLSH me shkresën Nr. 4388/26 Prot, datë 10.07.2024 brenda afatit **6 mujor** të raportimit, ***në përputhje me*** Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 pika 2 e tij.

-Sa më sipër rezultoi, se është zbatuar afati **6 mujor** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve të lëna, si pas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezultoi si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Të merren masa nga KLGJ/ Njësia e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, për auditimin e fondeve të akorduara gjykatave, në përputhje detyrimet ligjore, sa përcaktuar në Ligjin Nr. 115/2016, neni 96, pika 3 dhe 4.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht** pasi, nga KLGJ ka filluar auditimi fondeve akorduar gjykatave.

2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Sektori i Financës në KLGJ, që në pasqyrën financiare të vitit të 2023 të përjashtohet llogaritja e amortizimit të Fondit të librave/ Bibliotekës, në përputhje me këto standarde kombëtare të kontabilitetit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Sektori i Financës në KLGJ, në vijimësi për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, për një pasqyrim sa më të drejtë të pasqyrave financiare, me qëllim që të parandalohen gabimet apo parregullsitë e mundshme në interpretimin e llogarive të pasqyrave financiare.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

4.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Sektori i Financës në KLGJ, të llogarisë sërish diferenat dhe të marrë masat për sistemin e llogarive 467 “Kreditorë të ndryshëm” dhe llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”, duke ju referuar Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 i ndryshuar.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

5.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Sektori i Financës në KLGJ, për sistemin e llogarive dhe llogaritjen e saktë, në mënyrë që të rakordojë me kundër partitë respektive sipas përcaktimeve në planin kontabël të llogarive dhe akteve nënligjore që rregullojnë procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në institucionet e qeverisjes së përgjithshme.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

6.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Këshilli i Lartë Gjyqësor/Drejtoria e Burimeve Njerëzore për plotësimin e vendeve vakante/të lira sipas planeve vjetore të miratuara, me qëllim plotësimin e nevojave të institucionit për realizimin e detyrave në përputhje me strukturën e tij.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

7.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Këshilli i Lartë Gjyqësor/Drejtoria e Burimeve Njerëzore që në bashkëpunim me Këshillat e Gjykatave, të plotësohen vendet vakante në administratën gjyqësore, ku për njësitë strukturore/sector apo drejtori, të respektohet numri i parashikuar në VKM Nr. 893, datë 17.12.2014, pika 22, duke i përshtatur ato dhe me nevojat e gjykatës dhe aftësitë e personave në detyrë.

Menjëherë

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

8.1 Rekomandimi: Të merren masa nga KLGJ që, në ardhmen hartimi i kriterëve të veçanta të argumentohet në mënyrë të plotë dhe të qartë në procedurat e prokurimit publik, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes të operatorëve ekonomike.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

9.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Njësia e Prokurimit dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, që për procedurat e tenderimit që do të realizohen në të ardhmen, pjesë e dosjes së tenderit të jetë dhe analiza mbi kërkesat për planifikimin e nevojave për prokurim.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

9.2 Rekomandimi: Të merren masa nga KLGJ, që në të ardhmen si pjesë e dosjes së tenderit të jetë dhe shqyrtimi sugjerimeve të Koordinimit të APP-së në lidhje me DT si dhe për rastet e anulimit të procedurave të prokurimit të jetë dhe dokumentacioni për analizimin e shkaqeve të anulimit.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

9.3 Rekomandimi: Të merren masa nga njësia përgjegjëse për prokurimin ose zyrtari i caktuar që në të ardhmen si pjesë e dosjes së prokurimit të jetë dhe administrimi i gjurmës së botimit nga APP, në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

10.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Komisionet e Vlerësimit të Ofertave që për procedurat që do të realizohen në të ardhmen nga KLGJ, në procesverbalin e shqyrtimit të ofertave të pasqyrohen në mënyrë të qartë, të saktë dhe të plotë shkaqet e s kualifikimit/mos përmbushjes së kriterëve nga operatorët ekonomikë.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

11.1 Rekomandimi: Të merren masa nga strukturat përkatëse, që në të ardhmen dokumentacioni për miratimin e pjesëmarrësve në evente jashtë vendit, të përgatitet menjëherë pas marrjes dijeni nga organizatorët, me qëllim minimizimin e vonësve në fillimin e procedurës së prokurimit si dhe të administrohen fizikisht.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

12.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, që në bashkëpunim me QTI, të miratojë udhëzimet/manualët mbi mbikëqyrjen e përdorimit të sistemeve IT në gjykata, me qëllim monitorimin e vazhdueshëm të funksionimit të këtyre sistemeve nga KLGJ.

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

C. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Nga auditimi i veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brendshëm të KLGJ-së rezultoi se është vlerësuar nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, e cila me shkresën Nr.15710/5 prot., datë 17.12.2021 ka dërguar Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë. Për gjetjet e evidentuara nga kjo njësi (DH/AB) është ngarkuar me përgjegjësi z. A. M. me detyrë ish Drejtor i DAB, i cili deri në fund të muajit shtator 2021 ka mbuluar dhe ndjekur veprimtarinë e kësaj drejtorie. Nga KLSH u auditua statusi për 19 rekomandime të lëna, nga ku 18 rekomandime rezultojnë “të zbatuara” dhe 1 rekomandim “pjesërisht i zbatuar”. Me Vendimin Nr.18, Nr.4164/1 prot., datë 24.9.2021 është miratuar kërkesa për dorëheqje dhe përfundimin e marrëdhënieve në shërbimin civil të z. A. M. (Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 110-146 të Raportit të Auditimit)

Për ish punonjës A. M, nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore e rekomanduar do të ishte “*largim nga shërbimi civil*”, bazuar në Ligjin Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar neni 58, germa “ç” edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**, pasi për ish punonjës (AM) për të cilin është rekomanduar masa “*largim nga shërbimi civil*” dhe që në rekomandim është vlerësuar se nuk mund të ezaurohen si të tilla, se personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre, bazuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, është bërë njoftimi në Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore përkatësisht me shkresën 4388/18, datë 20.02.2024.

D.NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.

Për punonjës për të cilin është rekomanduar masa disiplinore sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecuresë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të *ndërmarrë veprimet si më poshtë:*

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi u konstatua se: Për sa më sipër trajtuar rekomandimet konsiderohen **të pranuar** nga subjekti dhe **të zbatuara plotësisht**.

2. INSTITUTI I GJEOSHKENCAVE

2.1 PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), ushtroi auditim tematik në **Institutin e Gjeoshkencave** (këtu e në vazhdim IGJEO) “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në

auditimet e evaduara në vitin 2023”, për periudhën objekt auditimi data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022, përcjellë me shkresën Nr. 331/7 Prot, datë 14.09.2023, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;

- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:

a. vendimeve (urdhrave) për zbatimin e masave organizative;

b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;

c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;

ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, IGJEO nuk e ka respektuar këtë afat duke mos kthyer përgjigje.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

-Në zbatim të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, subjekti i audituar nuk ka raportuar në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit prej 6 muaj.

III. Rekomandimet e KLSH-së

Sipas shkresës Nr.331/7 Prot, datë 14.09.2023, për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Auditimin e Përputhshmërisë” të ushtruar në **Institutin e Gjeoshkencave**, sipas programit të auditimit Nr.331/1 Prot, datë 20.04.2023, për veprimtarinë nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2022, janë rekomanduar 5-Masa Organizative, nga ky janë dhënë 6-rekomandime, të cilat konsiderohen të pranuar plotësisht nga subjekti pasi institucioni nuk është shprehur për mospranimin e tyre, referuar kërkesave e përcaktimeve të ligjit organik për KLSH dhe Vendimit të Kryetarit të KLSH-së Nr.67, datë 23.06.2020 “Për Miratimin e Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si dhe të regjistrimit institucional të zbatimit të rekomandimeve” faqe 14 , rekomandimet e lëna kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon, 1-zbatuar plotësisht, 3- zbatuar pjesërisht, 1- proces zbatimi, 1- pa zbatuar.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

IV. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH-së

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH-s me Nr.331/7 Prot, datë 14.09.2023 statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
1	Masa Organizative	6	6	-

V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e subjektit.

Në mënyrë të përmblledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
1	Organizative	6 Rekomandime	1	3	1	1
	Total	6	1	3	1	1

I/1 HYRJA

Auditimi është kryer në përputhje me Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit Nr.1420/2 Prot, datë 27.11.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u krye nga:

1. N.M, përgjegjëse grupi
2. M.M, anëtar.

Auditimi ka filluar më 02.12.2024.

Auditimi ka përfunduar më 20.12.2024.

I/2. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën Nr. 331/7 Prot, datë 14.09.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH-së.

I/3. QËLLIMI AUDITIMIT:

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I/4. METODOLOGJIA E AUDITIMIT:

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti dhe që ka lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektet në të ardhmen.

I/5. KONKLUSIONI:

Nga auditimi në terren i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti **Instituti i Gjeo Shkencave**, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën Nr.331/7 Prot, datë 14.09.2023, rezulton se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 5 Masa organizative, nga ku janë dhënë 6 rekomandime, të cilat kanë statusin e ecursë së zbatimit si vijon, 1- zbatuar plotësisht, 3- zbatuar pjesërisht, 1- proces zbatimi, 1- pa zbatuar.

II. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE:

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se shkalla e pranueshmërisë së rekomandimeve kundrejt atyre të pa pranuar rezultoi në nivel 100%, konkretisht nga **6** rekomandime gjithsej, janë pranuar **6** rekomandime.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara plotësisht rezultoi në masën **16,7%**, niveli i zbatimit të rekomandimeve të zbatuara pjesërisht rezultoi **50%**, niveli i rekomandimeve në proces zbatimi rezultoi **16,7%**, niveli i rekomandimeve të pa zbatuara rezultoi **16,7%**, nivele këto të cilat tregojnë mos vlerësimin e duhur të këtij procesi në lidhje me ndjekjen e procedurave të duhura për zbatimin e rekomandimeve.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM:

Nga auditimi i ushtruar në **Institutin e GjeoShkencave** për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “*Mbi auditimin e përputhshmërisë*” për periudhën nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2022 trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr.155, datë 11.09.2023, përcjellë me shkresën Nr.331/7 Prot, datë 14.09.2023, rezultoi si më poshtë vijon:

III/1-Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në germën (j) e nenit 15, të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **Instituti i Gjeo Shkencave**, nuk ka kthyer përgjigje në KLSH, brenda afatit ligjor.

-Sa më sipër rezultoi, se **nuk është zbatuar afati 20 ditor** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/2-Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecursë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e subjektit të audituar lidhur me raportimin mbi zbatimin të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara sipas strukturave përgjegjëse, subjekti nuk ka raportuar në KLSH me shkresën Nr. 4388/26 prot., datë 10.07.2024 brenda afatit **6 muaj** të raportimit, **në kundërshtim me Ligjin Nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30 pika 2 e tij.**

-Sa më sipër rezultoi, **së nuk është zbatuar afati 6 muaj** për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

III/3. Realizimi i rekomandimeve të lëna, si pas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, rezultoi si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të IGJEO-s në bashkëpunim me UPT të marrin masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve të nevojshme në stacionet sizmologjike në vend, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për monitorimin e aktivitetit sizmik në vend.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kontratën Nr.2432/2 Prot, datë 06.12.2024 UPT mbështetur në kërkesën e njësisë kryesore IGJEO, në planin e miratuar të buxhetit për vitin 2024 si dhe pas përfundimit të procedurave ligjore, ka lidhur kontratë me objekt “Ndërhyrje për Riparimin e Stacionit Sizmik dhe Sizometrik Shkodër” me afat realizimi 4 (katër) muaj nga data e fillimit të punimeve dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është i zbatuar pjesërisht.

-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

Observacion i ardhur nga IGJEO me shkresën Nr. 571/4 Prot, datë 11.02.2025, protokolluar në KLSH me Nr. 1420/7 Prot, datë 13.02.2025.

Pretendimi i subjektit:

Menjëherë pasi janë përfunduar procedurat ligjore dhe është lidhur kontrata me objekt "Ndërhyrje për Riparimin e Stacionit Sizmik dhe Sizometrik Shkodër", në bazë të kontratës nr.2432/10, me datë 06.12.2024, lidhur me autoritetin kontraktor Universiteti Politeknik i Tiranës, punimet për riparimin e Stacionit Sizmik Shkodër kanë filluar në datën 11.01.2025 dhe punimet kanë afat realizimi 4 (katër) muaj nga data e fillimit të punimeve. Personi përgjegjës për ndjekjen e punimeve nga ana e IGJEO-s do të jetë Z. B.R, punonjës ndihmës akademik dhe pjesë e Grupit Teknik. Angazhimi në këtë proces përfshin mbikëqyrjen e punimeve dhe sigurimin e përputhshmërisë me kontratën, koordinimin me palët e përfshira për një zbatim efikas, si dhe raportimin periodik mbi ecurinë e punimeve. Për më shumë, bashkëlidhur gjendet shkresa me Nr.83 prot. datë 10.02.2025 “Koordinimi dhe monitorimi në kuadër të zbatimit të kontratës nr. 2432/10 prot., datë 06.12.2024” si dhe shkresa me datë. 11.01.2025 Njoftim fillim punimesh në objektin "Ndërhyrje për Riparimin e Stacionit Sizmik dhe Sizometrik Shkodër".

Referuar observacionit të ardhur pas dërgimit të projekt raportit, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi të mos e marrë në konsideratë pasi dokumentacioni i sjellë nuk paraqet fakt të ri. Sjellim në vëmendjen tuaj se rekomandimit i dhënë i referohet të gjitha stacioneve sizmike në rang kombëtar, pra jo vetëm stacionit sizmik të Shkodrës në mënyrë të posaçme. Për më tepër, referuar procesit të inventarizimit të stacioneve sizmike në vend me datë 13.02.2024 të ngritur me Urdhrin Nr.5, datë 08.09.2023 “Për ngritjen e Komisionit të Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve të IGJEO”, citohet gjendja emergjente e tyre në stacionet sizmike në Bajram Curri, Durrës, Fier, Himarë, Korçë etj.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri dhe nuk do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet .

2.1 Rekomandimi: IGJEO të rrisë shkallën e bashkëpunimit me UPT në mënyrë që të merren masa për realizimin e programit vjetor të investimeve sipas planifikimit të fondeve të miratuara në PBA me qëllim të përdorimit sa më eficient të tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kontrata Nr.2601/15 Prot, datë 07.02.2024 me objekt “F.V pajisje për dhomë serveri të standardizuar dhe rikonstrukcion i rrjetit elektrik dhe lan për nevoja të IGJEO”; kontrata Nr.1255/10 Prot,

datë 24.07.2023 me objekt “Furnizim dhe vendosje e shtyllave të përkulshme metalike me lartësi 10 m e lartë nga sipërfaqja e tokës për vendosjen e sensorëve të erës”; proces verbal Nr.1, datë 17.05.2023 mbi dorëzimin e produkteve sipas kontratës me Nr.2969/26 Prot, datë 27.03.2023 me objekt “Blerje pajisje laboratorike për njësitë e UPT”; kontrata Nr.2138/10 Prot, datë 01.11.2022 me objekt “Blerje pajisje për stacione hidrologjike dhe meteorologjike” dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është i zbatuar plotësisht.

-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar plotësisht**.

3.1 Rekomandimi: Specialisti i personelit në IGJEO, të marrë masa për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin përkatës .

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është në proces zbatimi.

-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Observacion i ardhur nga IGJEO me shkresën Nr. 571/4 Prot, datë 11.02.2025, protokolluar në KLSH me Nr. 1420/7 Prot, datë 13.02.2025.

Pretendimi i subjektit:

Referuar Rekomandimit 3.1, Dosjet e personelit janë të plotësuara me dokumentacionin përkatës, në përputhje me Neni 25 Specialisti i personelit dhe arkivit shkresor, Pika 1. të Rregullores së Brendshme të IGJEO dhe gjenden në zyrën e Burimeve Njerëzore të IGJEO.

Referuar observacionit të ardhur pas dërgimit të projekt raportit, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi të mos e marrë në konsideratë pasi dokumentacioni i ardhur nuk ka sjellë asnjë fakt shtesë apo dokumentacion mbështetës pas fazës së terrenit.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrimin tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri dhe nuk do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet .

3.2 Rekomandimi: Titullari i Institucionit të IGJEO-s të marrë masa për përcaktimit e kritereve të punësimit të unifikuara sipas përcaktimeve në statutin e UPT në të gjitha procedurat e punësimit, dhe praktikën e punësimit të shoqërohet për transparencë me datën e publikimit në APP.

Në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në mungesën e dokumentacionin justifikues dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është i pa zbatuar.

-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

Observacion i ardhur nga IGJEO me shkresën Nr. 571/4 Prot, datë 11.02.2025, protokolluar në KLSH me Nr. 1420/7 Prot, datë 13.02.2025.

Pretendimi i subjektit:

Referuar Rekomandimit 3.2, sqarojmë se në të gjitha rastet e punësimit të stafit të IGJEO, kemi respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi, konkretisht:

Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015, Neni 64 Punësimi i Personelit Akademik, pika 1: Kriteret e punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori i UPT. Konkursi në institucionet publike të arsimit të lartë (IAL) drejtohet nga një komision ad-hoc i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Rregullat dhe procedurat për përzgjedhjen e anëtareve të komisionit ad-hoc, si edhe të përzgjedhjes së personelit akademik caktohen në Statutin e IAL-së.

Sipas Statutit të UPT, Neni 42 Punësimi i Personelit Akademik, Pika 1 deri Pika 14, japin detaje mbi kriteret dhe procedurat e punësimit të personelit akademik.

Veçanërisht, në Pika 9 e Statutit të UPT thuhet shprehimisht:

“- njësia bazë përcakton nevojat dhe kriteret specifike për vendin e punës vakant

- komisioni ad-hoc vlerëson dhe rendit kandidatet për vendin e punës në fjalë dhe ia përcjell rektorit të UPT për miratim

-Rektori i UPT shpall kandidatin fitues dhe lidh kontratën e punës me të.”

Ndërkohë, në Pika 14 e Statutit të UPT thuhet: “Procedura e detajuar e punësimit të personelit akademik në UPT, përcaktohet në rregulloren e tij.”

Theksojmë se, për çdo punësim të ri në IGJEO, janë ndjekur të gjitha procedurat bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015, Statutin e UPT, si dhe Rregulloren e Brendshme të IGJEO (Neni 20). Bashkëlidhur, gjendet 1 (një) shembull konkret i procedurës së plotë të punësimit të një punonjësi të stafit akademik në IGJEO, përkatësisht: Znj. E. K ku, evidentohen kriteret e punësimit të përcaktuara nga Përgjegjësi i Departamentit të Meteorologjisë. Gjithashtu, shkresa Nr.116 prot., Date 18.01.2022 “Kërkohet ngritja e komisioneve për zhvillimin e konkursit”, ka njoftim që për rastin e punësimit të punonjësit në fjalë është bërë shpallja publike në Agjencinë e Prokurimit Publik (APP). Bashkëngjitur këtij dokumenti, gjendet Pjesa e Statutit të UPT lidhur me punësimin e personelit në institucionet e arsimit të lartë ku hyn edhe IGJEO.

Referuar observacionit të ardhur pas dërgimit të projekt raportit, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi të mos e marrë në konsideratë pasi argumentimi i dhënë nuk sjellë të dhëna shtesë në lidhje me statusin e rekomandimit të lënë nga grupi i auditimit.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri dhe nuk do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet .

4.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të IGJEO dhe drejtorët e departamenteve përkatëse, sipas detyrave të tyre funksionale të marrin masa për ngritjen e laboratorit, mbajtjen e një regjistri të arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, zhvillimin e studimeve mbi biomasën dhe zhvillimin e modeleve gjeo-informatike. Gjithashtu ngritjen dhe përfshirjen në strukturën e IGJEO-s të një njësie të specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore, me qëllim arritjen e objektivave të Institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion si më sipër dhe argumentimit të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është i zbatuar pjesërisht.

-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

Observacion i ardhur nga IGJEO me shkresën Nr. 571/4 Prot, datë 11.02.2025, protokolluar në KLSH me Nr. 1420/7 Prot, datë 13.02.2025.

Pretendimi i subjektit:

-Një regjistër i arkivuar mbi kontributin e dhënë nga IGJEO për doktorantët e rinj ekziston në Rektorat dhe duhet kërkuar atje. Stafi përgjegjës në rektorat, në bazë të raportit vjetor të realizimit të punës kërkimore shkencore dhe mësimdhënies të IGJEO, ndërton dhe pasuron regjistrin e arkivuar për IGJEO si dhe të gjitha fakultetet që UPT ka nën varësi.

-IGJEO nuk i ka prioritare studimet mbi biomasën. Për më tepër, nuk ka staf që të mbulojë këtë fushë. Kështu, sipas Rregullores së Brendshme të IGJEO, Neni 3: "IGJEO (ish IGJEUM) mbulon fushat e kërkimit shkencor të gjeologjisë, sizmologjisë, meteorologjisë, hidrologjisë dhe mjedisit dhe realizon ekspertizë për të gjithë aktivitetin në këto fusha."

-Referuar Rregullores së Departamentit të Gjeologjisë, nuk janë kërkuar dhe as ndërtuar modele gjeo-informatike. Janë kërkuar trajnime në disa programe kompjuterikë për realizimin e hartave dhe database përkatëse shoqëruese. Gjithashtu, janë kërkuar software dhe hardware në buxhetin e çdo viti por nuk ka patur financim. Për çështjet e tjera të Rekomandimit 4.1 vlejné komentet e sipërpërmendura të ofruara nga ana e IGJEO.

Referuar observacionit të ardhur pas dërgimit të projekt raportit, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi të mos e marrë në konsideratë pasi argumentimi i dhënë është i njëjtë me fazën e terrenit.

Qëndrimi i grupit të Auditimit

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoj me vëmendje parashtrim tuaj, konkludon se argumentimi nuk paraqet *fakt të ri dhe nuk do të pranohet*. Sa më sipër, observacioni nuk merret në konsideratë.

Observacioni mësipërm nuk pranohet.

5.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të IGJEO-s, të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve në pronësi të Institutit, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nga verifikimi u konstatua se: Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion Urdhri Nr.5, datë 08.09.2023 "Për ngritjen e Komisionit të Inventarizimit dhe Vlerësimit të Aktiveve të IGJEO" dhe relacion ne lidhje me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve dhe gjendja e tyre me Nr.401/2 Prot, datë 13.02.2024 dhe argumentimeve të Institucionit, konkludohet se rekomandimi është i zbatuar pjesërisht.

-Për sa më sipër trajtuar, rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

Observacion i ardhur nga IGJEO me shkresën Nr. 571/4 Prot, datë 11.02.2025, protokolluar në KLSH me Nr. 1420/7 Prot, datë 13.02.2025.

Pretendimi i subjektit:

Bazuar në Urdhrin Nr.5, datë 08.09.2023 për "Inventarizimin e aktiveve", duke ju referuar dokumentacionit bashkëlidhur mbi Inventarizimin e stacioneve sizmike, datë 13.02.2024, janë marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve në pronësi të Institutit dhe janë kryer procedurat e inventarizimit fizik të pasurisë për stacionet sizmike, hidrologjike dhe meteorologjike, në pronësi të IGJEO-s.

Në përfundim të procesit të inventarizimit, referuar vlerësimit nga ana e komisionit është realizuar evidentimi dhe nxjerrja jashtë përdorimit e disa aktiveve, si kompjuter, printer,

makina, etj. si dhe jemi në proces të nxjerrjes jashtë përdorimit të disa orendive dhe pajisjeve teknike laboratorike.

Referuar observacionit të ardhur pas dërgimit të projekt raportit, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë por statusi i rekomandimit mbetet i njëjtë si rezultat i mos finalizimit të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit .

Qëndrimi i grupit të Auditimit:

Referuar observacionit të ardhur pas dërgimit të projekt raportit, grupi i auditimit pasi shqyrtoi me vëmendje pretendimin e subjektit vendosi ta marrë në konsideratë por statusi i rekomandimit mbetet i njëjtë si rezultat i mos finalizimit të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit .

-Sa më sipër, observacioni merret në konsideratë, por pa ndryshuar statusin e rekomandimit.

Observacioni mësipërm pranohet dhe u reflektua në Raport Përfundimtar.

Ri kërkojmë që, IGJEO të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e të gjitha rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara dhe atyre pjesërisht zbatuar si dhe përsheptimin e atyre në proces, brenda 3-mujorit të parë të vitit 2025.

1.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të IGJEO-s në bashkëpunim me UPT të marrin masa për planifikimin dhe realizimin e investimeve të nevojshme në stacionet sizmologjike në vend, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për monitorimin e aktivitetit sizmik në vend.

Brenda muajit Mars 2025

3.2. Rekomandimi: Titullari i Institucionit të IGJEO-s të marrë masa për përcaktimit e kriterëve të punësimit të unifikuara sipas përcaktimeve në statutin e UPT në të gjitha procedurat e punësimit, dhe praktikat e punësimit të shoqërohet për transparencë me datën e publikimit në APP.

Brenda muajit Mars 2025

4.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit të IGJEO dhe drejtorët e departamenteve përkatëse, sipas detyrave të tyre funksionale të marrin masa për ngritjen e laboratorit, mbajtjen e një regjistri të arkivuar mbi kontributin e dhënë nga Institucioni për doktorantët e rinj, zhvillimin e studimeve mbi biomasën dhe zhvillimin e modeleve gjeo-informatike. Gjithashtu ngritjen dhe përfshirjen në strukturën e IGJEO-s të një njësie të specializuar vetëm për vlerësimin e riskut dhe rreziqeve natyrore, me qëllim arritjen e objektivave të Institucionit.

Brenda muajit Mars 2025

5.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të IGJEO-s, të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimin e aktiveve në pronësi të Institutit, si dhe nëse konstatohen aktive të dëmtuara ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimi.

Brenda muajit Mars 2025

ANEKSI 1:

SHKALLA E PRANUESHMËRISË DHE ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE SIPAS LLOJIT TË MASËS PËR SECILIN SUBJEKT TË AUDITUAR

Nr.	Subjektet dhe lloji i masave	Gjithsej	Nga këto		Nga rekomandimet e pranuar			
			Pranuar	Pa pranuar	Zbatuar	Zbatuar pjesërisht	Në proces	Pa zbatuar
	Totali	21	21	0	16	3	1	1
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa organizative</i>	20	20		15	3	1	1
	<i>Masa Administrative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Te ardhura te munguara</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Njoftim APP/DAP</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa disiplinore</i>	1	1	0	1	0	0	0
1	KL GJ	15	15	0	15	0	0	0
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa organizative</i>	14	14	0	14	0	0	0
	<i>Masa Administrative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa disiplinore</i>	1	1	0	1	0	0	0
2	IGJEO	6	6	0	1	3	1	1
	<i>Përmirësime për ndryshime ligjore</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa organizative</i>	6	6	0	1	3	1	1
	<i>Masa Administrative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për shpërblim dëmi</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa për eliminimin e efekteve financiare negative</i>	0	0	0	0	0	0	0
	<i>Masa disiplinore</i>	0	0	0	0	0	0	0

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT